



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1027/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPT “Herolinda” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2590/19, të datës 27.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2590/19, të datës 27.07.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.2590/19, të datës 27.07.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit NPT “Herolinda” me seli në Prishtinë II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/493/2017 i datës 25.09.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NPT “Herolinda” me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 2,970.00€ (dy mijë e nëntë qind e shtatëdhjetë euro e zero cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R-32597/30.06.2017, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e pagesës së detyrimeve importuese doganore 03.07.2017, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar A.nr.2590/19, të datës 27.07.2021 ta prish si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe

kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar, ose t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/493/2017 i datës 25.09.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedure NPT "Herolinda" me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr. R-32597/30.06.2017 të ZBD Prishtinë, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 01.11.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/493/2017 i datës 25.09.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se nga arsyetimi i vendimit të kontestuar A.nr.01.3.2.2/493/2017 25.09.2019, gjykata ka konstatuar faktin se e paditura duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1653/17 të datës 06.06.2019, ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit me nr.R-32597/30.06.2017 të ZBD P., me të cilin vendim paditësit i është ri vlerësuar vlera e deklaruar e mallit, me arsyetimin se Njësia e Inspektimit Pas Zhdoganimit, ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim, nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim importi në vendin tonë, për arsye se, është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Sipas të paditurës-Sektorit për Rishqyrtimin e Vendimeve, në rastin konkret nuk janë gjetur të dhëna për vlerësimin e mallit sipas metodave paraprake dhe se Njësia e Inspektimit Pas Zhdoganimit nuk ka vepruar drejt kur ka aplikuar metodën e tretë të vlerësimit, andaj duhet të aplikohet metoda e gjashtë e vlerësimit në harmoni me dispozitat e nenit 35 të KDAK-së, gjithnjë duke pas parasysh se subjekti nuk ka bashkangjitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar, për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e paguar për mallin lëndor kontestues. Nga një situatë e tillë faktike, gjykata konstaton se e paditura edhe pse vendimin kontestues e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1653/17 i datës 06.06.2019, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e gjykatës, dhe në këtë mënyrë ka dështuar ti ketë parasysh detyrimet

ligjore nga neni 65 i LKA-së, ku parashihet karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit. Në këtë drejtim gjykata konstaton që e paditura në rivendosje ishte obliguar nga gjykata që ti shqyrtoj pretendimet e paditësit, të cilat i ka cekur në kërkesën për rishqyrtimin e vendimit R-32597/30.06.2017 të ZBD Prishtinë, ashtu që të verifikoj të gjithë dokumentacionin përcjellës të mallit doganor të deklaruar pranë zyrës doganore dhe në procedurë administrative të ankesave, dhe të nxjerr konstatimin se a është paraqitur dokumentacioni i duhur, në kuptim të vlerës së mallit, sipas faturës përcjellëse të mallit dhe transferit bankar, si dhe të vlerësoj se a janë plotësuar kushtet ligjore për tu aplikuar neni 33 i KDAK-së, mirëpo e paditura përkundër këtyre pikëpamjeve juridike të gjykatës, në ri procedurë nuk ka vepruar fare komfor këtyre udhëzimeve, por sërish ka insistuar në atë se në rastin konkret nga paditësi është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së, dhe se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pa mjaftueshme, pasi që subjekti ankimor ka prezantuar kontratën e shitblerjes të mallrave, e cila nuk është nënshkruar nga eksportuesi i malli, por vetëm nga importuesi, e që për Doganën ky fakt tregon se dokumentacioni nuk është i harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar prova për të vërtetuar gjendjen faktike por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr një konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit. Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se në deklaratë doganore të paditësit kanë qenë të bashkangjitura fatura dhe transaksioni bankar, në tërësi të harmonizuara dhe në përputhje me nenin 123 të UA për implementimin e KDA-së, është konkluzion i gabuar dhe gjithashtu interpretim i gabuar i gjykatës. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate

nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse Gjykata ka vlerësuar se e paditura, as me vendimin e parë me nr.01.3.2.2/493 të datës 21.08.2017, kur ka refuzuar ankesën e paditësin, por as në vendimin e kontestuar dhe në këtë procedurë gjyqësore të konflikt administrativ, nuk ka arritur ta mbështesë në prova materiale konkrete, përmes të cilave do të mund të dëshmohej se paditësi i ka paguar shitësit të mallit-eksportuesit-subjektit “Mida” LTD nga Bullgaria, mbi çmimin neto të pro faturës së mallit dhe faturës së blerjes së mallit me nr.197 të datës 29.06.2017, ku vlera e shënuar e mallit është në shumë prej 22,000.00€, si dhe transaksionin bankar të 27.06.2017, ku i është bërë pagesa eksportuesit të mallit në vlerë prej 22,000.00€, me përshkrimin bankar të mallit të importuar. Tutje për konstatimin e të paditurës se subjekti ankimor ka prezantuar kontratën e shitblerjes të mallrave, e cila nuk është nënshkruar nga eksportuesi i malli, por vetëm nga importuesi, gjykata ka vlerësuar se ky konstatim i të paditurës është në tërësi i pa bazuar, sepse nga kontrata-marrëveshje për shitblerjes të mallrave e datës 12.06.2017 e lidhur në mes të eksportuesit të mallit-subjektit “Mida” LTD nga Bullgaria dhe këtu paditësit, rezulton se kjo kontratë është nënshkruar dhe vulosur nga të dy palët kontraktuese në gjuhën bullgare, dhe të njëjtës paditësi në këtë procedurë gjyqësore i ka bashkangjitur edhe përkthimin e legalizuar në gjuhën shqipe nga ana e interpretit gjyqësor. Edhe në këtë kontratë të shitblerjes rezulton që palët kontraktuese janë marr vesh që shitësi shet mallin lëndor “fara të kungullit” në sasi prej 22.000kg, me çmim 1€ për kg, çka rezulton se edhe përmes këtij dokumenti provohet harmonizimi si i llojit të mallit, sasisë dhe çmimit të mallit me vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi përmes DUD-it-R32597/30.06.2017. Për më tepër gjykata konstaton se edhe malli i marr për krahasim nga e paditura me mallin lëndor, dhe i zhdoganuar përmes DUD-it R-2827/09.06.2017, nuk mund të shërbej si bazë tu rivlerësuar malli i paditësit, ngase në rastin konkret nuk plotësohen parakushtet ligjore për tu trajtuar këto mallra si mallra të ngjashme, sipas nenit 61 par.1 pika d) të UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, kjo për faktin se, nuk janë të prodhuar në një vend, respektivisht malli lëndor i paditësit ka origjinë nga Bullgaria, i cili është edhe vend eksportues, ndërsa malli i marr për krahasim (çmimi i tij) është me origjinë nga Serbia, përderisa vend eksportues është Mali i Zi, pastaj dallon malli në karakteristika, pasi që malli i importuar nga paditësi është i llojit refuz ndërsa malli krahasues i marr është i paketuar, ndryshojnë si subjekti eksportues, ashtu edhe ai importues. Andaj në rrethanat e rastit konkret kur paditësi për të dëshmuar vlerën doganore të mallit të importuar-çmimin transkasional, përmes DUD-it R-32597/30.06.2017, ka paraqitur në procedurë të zhdoganimit të mallit tek e paditura dokumentacionin përcjellës të mallit në përbërje si; pro fatura e mallit e lëshuar nga eksportuesi i mallit në shumë prej 22,000.00€, faturën e blerjes së mallit me nr.197 të datës 29.06.2017, kontratën e shitblerjes së mallit të datës 12.06.2017 të lidhur me eksportuesin, deklaratën eksportuese të datës 29.06.2017 të lëshuar nga shteti eksportues, si dhe urdhër pagesën bankare ndërkombëtare të datës 27.06.2017, nga ku vërtetohet çmimi i paguar i mallit lëndor nga paditësi për eksportuesin në shumë prej 22.000.00€, gjykata vlerëson se e paditura në këtë rast ka nxjerr konkluzion jo të drejt të gjendjes faktike dhe nuk ka zbatuar në mënyrë të drejt dispozitat e KDAK-së dhe UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, sepse të gjitha dokumentet e paraqitura nga paditësi rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1027/22, me datë 18.12.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami